**R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA DURRËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit**

Datë 16.07.2026

# RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin *(titulli i projektvendimit)*: **PËR MIRATIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT VENDOR TË RINISË, SI DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË TIJ**

**Baza ligjore:**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 75/2019 "Për Rininë", i ndryshuar me Ligjin nr. 24/2025, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 969, datë 2.12.2020, të ndryshuar me VKM-në nr. 598, datë 15.10.2025, "Për përcaktimin e kritereve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 82, datë 28.06.2021 "Për miratimin e kritereve, procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij".

**Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër** *(Çfarë propozohet në projektvendim):*

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe të vendosë:

1. Për miratimin e kritereve, procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Durrës, si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij", sipas aneksit Nr. 1.

2. Aneksi Nr. 1 i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 82, datë 28.06.2021 "Për miratimin e kritereve, procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij", shfuqizohet.

4. Ngarkohet Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare për zbatimin e këtij vendimi.

**Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):**

-

**Drejtoria/Sektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:**

Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare.

**Impakti social/grupet që preken:**

Banorë të bashkisë Durrës... (Rinia)

**A është objekt konsultimi:** *(PO/JO)*

*JO*

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, u mblodhë më datë 16.07.2026, dhe shqyrtoi pikën nr. 3 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Komisioni u mblodh dhe mori në diskutim pikën 3 të rendit të ditës. Në prezencën e drejtoreshës M. Muhaj anëtarët e komisionit u qartësuan me ndryshimet e ligjit të rinisë i cili përfshin 1/3 e nr të anëtarëve të Këshillit Bashkiak. Nuk pati paqartësi të tjera dhe të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje ranë dakord që pika të kalojë në mbledhjen e nesërme të këshillit bashkiak.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

**T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:**

a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
b- Miratimin e projekt aktit
c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
e- ___________________________________

**Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Kryetar | Kastriot Xhongoli |
| 2 | Zv/Kryetar | Blerina Reçi |
| 3 | Sekretar | Ilir Paja |
| 4 | Anëtar | Nurije Gjoni |
| 5 | Anëtar | Ermal Braholli |